



Podujevë, 24 maj 2022

KOMUNA E PODUJEVËS NË PARTNERITET ME PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË
LOKALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR 2 (ReLOaD2) SHPALL:

Thirrjen për aplikim për “Udhëheqës i komunitetit të të rinjve”

Programi ReLOaD2 është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën. Objektivi i përgjithshëm i programit ReLOaD2 është të forcojë demokracinë lokale dhe procesin e integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE. Gjithashtu, programi ReLOaD2 synon të promovojë angazhimin e të rinjve në mënyrë që të bëhen pjesë e proceseve vendimmarrës në funksion të zhvillimit të komunitetit. Në kuadër të kësaj, ReLOaD2 ka planifikuar të rris përfshirjen e të rinjve përmes identifikimit dhe angazhimit vullnetar të **“Udhëheqësve të komunitetit të të rinjve”** në promovimin dhe zbatim e nismave rinore. Udhëheqësit e komunitetit të të rinjve do të angazhohen për të ndihmuar në mbajtjen e forumeve tematike dhe diskutimeve me qëllim identifikimin e çështjeve kryesore për të rinjtë në komunitetet lokale dhe t’i nxisin të rinjtë që të marrin pjesë në çështjet dhe aktivitetet e komunitetit të tyre.

Bazuar në këtë, Komuna e Podujevës dhe programi ReLOaD2 ftojnë të rinjtë e interesuar të aplikojnë për të qenë Udhëheqës i komunitetit të të rinjve deri në fund të vitit 2024. Këshillat rinorë lokalë dhe/ose shoqatat rinore, inkurajohen që të nominojnë përfaqësuesit e tyre. Për t’u kualifikuar, aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë banor i komunës së Podujevës;
- Të ketë pozitë specifike dhe kompetenca brenda komunitetit të të rinjve;
- Të jetë i moshës 18 – 29 vjeç;
- Të jetë aktualisht i përfshirë në aktivitetet vullnetare në komunitet/komunë;
- Të ketë përvojë dhe të jetë i përfshirë në diskutime tematike gjinore;
- Të ketë përvojë dhe të jetë i përfshirë në aktivitete me personat me aftësi të kufizuara.

Nuk kanë të drejtë aplikimi punonjësit e komunës dhe anëtarët e familjeve të tyre.

Të interesuarit duhet të dërgojnë CV-në e tyre në formë elektronike tek Memli Gashi në email adresën memli.gashi@rks-gov.net . **Afati i aplikimit nga data 25 - 31 maj 2022/ora 15:30.**

Vlerësimin e aplikacioneve do ta bëjë paneli i vlerësimit i përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë për Rini, Kulturë dhe Sport dhe UNDP / ReLOaD2.

Shënim: Gjatë përzgjedhje do të sigurohen parimet e barazisë gjinore, duke ofruar gjithashtu mundësi të barabarta për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të cënueshme.